



GJITHÇKA QË
DUHET TË
DINI RRETH
MATURËS DHE
PROVIMIT
PROFESIONAL

GJITHÇKA QË DUHET TË DINI RRETH
MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL

BOTUESI

IP Qendra e Provimeve

PËR BOTUESIN

Mr. Millosh Triviq

AUTORJA DHE REDAKTORJA

Tamara Nedoviq

DIZAJNI DHE PËRGATITJA TEKNIKE

Mr. Svetllana Llolla Miligkoviq

PËRKTHEU

Luigj Berisha

www.iccg.co.me





GJITHÇKA QË DUHET TË DINI RRETH MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL

PODGORICË, 2025



TË NDERUAR NXËNËS*,

DËSHIRA JONË ËSHTË QË ME KËTË BROSHURË T'JU OFROJMË TË GJITHË INFORMACIONIN E NEVOJSHËM PËR PROVIMIN E MATURËS DHE PROVIMIN PROFESIONAL. NE KEMI PËRMBLEDHUR TË GJITHA PËRMBAJTJET QË BESOJMË SE DO T'JU SHËRBEJNË SI BAZË PËR PROCESIN E PËRGATITJES DHE REALIZIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS DHE ATYRE PROFESIONALE. BROSHURA PËRMBAN INFORMACION KYÇ PËR PROCEDURAT, RREGULLAT DHE BURIMET TË CILAT DO T'JU NDIHMOJNË TË PËRGATITENI DHE TË KALONI PROVIMET ME SUKSES.

NËPËRMJET DISA HAPAVE, NE U PËRGJIGJEMI TË GJITHA ATYRE PYETJEVE QË NXËNËSIT MUND TË HASIN NË PROCESIN E PËRGATITJES DHE DHËNIES SË PROVIMEVE DHE QË I KEMI HASUR NË PUNËN DHE KOMUNIKIMIN E MËPARSHËM ME NXËNËSIT.

NE BESOJMË SE UDHËZIMET E DHËNA DO T'JU NDIHMOJNË TË NDIHENI MË TË SIGURT DHE MË TË PËRGATITUR.

NËSE KENI NDONJË PYETJE OSE MËDYSHJE, MOS NGURRONI TË KONTAKTONI EKIPI E QENDRËS SË PROVIMEVE, I CILI ËSHTË GJITHMONË I GATSHËM T'JU MBËSHITESË DHE T'JU PËRGJIGJET TË GJITHA PYETJEVE TUAJA.

JU UROJMË SUKSESE NË PROVIMET E ARDHSHE DHE REALIZIMIN E DËSHIRAVE DHE SYNIMEVE TUAJA PROFESIONALE DHE PERSONALE.

MR. MILLOSH TRIVIQ

** Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë broshurë për personat fizikë në gjininë mashkullore përfshijnë të njëjtat shprehje në gjininë femërore.*

HYRJE

PYETJET MË TË SHPESHTA PËR PROVIMIN E MATURËS DHE PROVIMIN PROFESIONAL

ÇFARË ËSHTË PROVIMI I MATURËS/ PROVIMI PROFESIONAL?

Provimi i Maturës/Provimi Profesional është kontrollim i standardizuar i arritjeve shkollore të nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm katërvjeçar.

SI JEPET PROVIMI I MATURËS/PROVIMI PROFESIONAL?

Provimi i Maturës/Provimi Profesional jepet në mënyrë eksterne, me ç'rast për të gjithë nxënësit vlejné rregullat unike të provimit. Kjo nënkupton që përmbajtja e testit për disa lëndë mësimore është e njëjtë për të gjithë, se testimi bëhet të njëjtën ditë dhe në të njëjtën orë në të Gjithë Malin e Zi, kurse vlerësimin e bëjnë vlerësuesit e pavarur.

KUSH I NËNSHTROHET PROVIMIT TË MATURËS?

Provimit të Maturës i nënshtrohen nxënësit e programeve të arsimit të gjimnazit të cilët me dhënien e Provimit të Maturës e përfundojnë arsimin e mesëm, si dhe personat të cilët e kanë përfunduar kursin e Maturës.

KUSH I NËNSHTROHET PROVIMIT PROFESIONAL?

Provimit Profesional i nënshtrohen nxënësit të cilët e kanë përfunduar vitin e katërt të programeve të arsimit profesional dhe artistik, personat që kanë përfunduar vitin e katërt të gjimnazit dhe kursin profesional, si dhe personat që kanë përfunduar shkollën profesionale trevjeçare, të cilët kanë dhënë

provimin përfundimtar dhe të cilët kanë kryer arsimin plotësues në kohëzgjatje prej dy vjetësh.

Nxënësit e shkollave profesionale dhe artistike mund t'i nënshtrohen Provimit Profesional në mënyrë eksterne (në organizimin e Qendrës së Provimeve) dhe në mënyrë interne (në organizimin e shkollës).

Nxënësit të cilët e japin Provimin e Maturës/Provimin Profesional në mënyrë eksterne fitojné kushtin e përgjithshëm për vazhdimin e arsimit në një institucion universitar.

CILI ËSHTË QËLLIMI I PROVIMIT TË MATURËS/ PROVIMIT PROFESIONAL?

Qëllimi i futjes së këtij provimi është përmirësimi i cilësisë së arsimit, një vlerësim sa më objektiv dhe uniform i arritjeve të nxënësve, bazuar në standarde të matshme njohurish.

KUSH E REALIZON PROVIMIN E MATURËS/ PROVIMIN PROFESIONAL?

Provimin e Maturës/Provimin Profesional e organizon dhe e realizon Qendra e Provimeve (QP). Qendra e Provimeve kryen punët profesionale, zhvillimore, organizative dhe administrative lidhur me realizimin e Provimit të Maturës.

KUSH E PËRGATIT MATERIALIN E PROVIMIT?

Materialin e provimit e përgatisin anëtarët e komisioneve të lëndës të përbërë nga profesorët e universitetit, shkollave të mesme dhe shkollave fillore.

Informacion më të detajuar rreth dhënies së provimit mund të gjeni në Rregullore, të cilat mund t'i shikoni në linqet e mëposhtme:

<https://www.gov.me/dokumenta/4ca3f585-e46d-4b45-ade6-72b713e57796>

<https://www.gov.me/dokumenta/8e9e0171-d32f-4dc7-ae24-de2eac0a5a78>

<https://lccg.co.me/wp-content/uploads/2020/12/PRAVILNIK-O-NACINU-I-POSTUPKU-POLAGANJA-STRUCNOG-ISPIITA-ZA-UCENIKE-KOJI-NE-NASTAVLAJU-OBRADOVANJE.pdf>

PËRMBAJTJA E PROVIMIT TË MATURËS/ PROVIMIT PROFESIONAL

Provimi i Maturës përbëhet nga një pjesë e detyrueshme dhe pjesa me zgjedhje. Të gjitha lëndët mësimore në Provimin e Maturës jepen nëpërmjet zhvillimit të testit. Lëndët e detyrueshme jepen në organizimin e Qendrës së Provimeve, ndërsa lënda e zgjedhjes së nxënësit jepet përpara komisioneve vlerësuese të cilat formohen në gjimnaz.

Lëndët e detyrueshme mësimore për gjimnazin e përgjithshëm, degën e gjimnazit sportiv dhe gjimnazit dygjuhësh janë:

- ▶ Gjuha malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsia/Gjuha shqipe dhe letërsia,
- ▶ Matematika ose gjuha e parë e huaj.

Matematika dhe gjuha e parë e huaj jepen në nivelin bazë ose në nivelin më të lartë. Nxënësi zgjedh njërin nga këto dy lëndë, si dhe nivelin në të cilin do ta japë.

Lëndët e detyrueshme mësimore për degën e specializuar të gjimnazit filologjik janë:

- ▶ Gjuha malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsia/Gjuha shqipe dhe letërsia,
- ▶ gjuha e parë e huaj.

Gjuha e parë e huaj jepet në nivelin bazë ose në nivelin më të lartë. Nxënësi zgjedh nivelin në të cilin do ta japë këtë lëndë.

Lëndët e detyrueshme mësimore për degën e specializuar të gjimnazit matematikor janë:

- ▶ Gjuha malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsia/Gjuha shqipe dhe letërsia,
- ▶ Analiza me algjebër ose matematika.

Analiza me algjebër ose matematika jepet në nivelin bazë ose në nivelin më të lartë. Nxënësi zgjedh nivelin në të cilin do ta japë këtë lëndë.

Lënda mësimore me zgjedhje nga nxënësi është lënda me rëndësi për vazhdimin e arsimit, për të cilën në planin mësimor është përcaktuar standardi i Maturës.

Çfarë është standardi i Maturës?

Standardi i Maturës së një lënde paraqet njohuritë që duhet të fitojë një nxënës në përfundim të arsimit në gjimnaz dhe shprehet me numrin e orëve të nevojshme për ndjekjen e mësimi për të fituar të drejtën për të dhënë një lëndë të caktuar në Provimin e Maturës.

Një numër më i vogël i lëndëve me zgjedhje të detyruar kanë standardin e përputhjes me standardin e Maturës, ndërsa tek numri më i madh i lëndëve është e nevojshme plotësimi i standardit të Maturës përmes përzgjedhjes së lëndëve përkatëse me zgjedhje të detyruar.

Për këtë patjetër duhet pasur kujdes me rastin e vendosjes se cilën lëndë do ta jepni si lëndë të rëndësishme.

Nëse jeni ende në dilemë nëse lënda mësimore që keni zgjedhur plotëson standardin e Maturës, mund të konsultoheni me **eporin e klasës** ose me **koordinatorin e shkollës për Provimin e Maturës**.

Nëse dëshiron, nxënësi mund të zgjedhë dhe të japë gjuhën angleze ose matematikën si lëndë me rëndësi. Provimin e jep në organizimin e Qendrës së Provimeve dhe mund ta japë në nivelin bazë dhe më të lartë.

PËR SHENBULL:

1. GJUHËN MALAZEZE-SERBE, BOSH-NJAKE, KROATE DHE LETËRSINË/ GJUHËN SHQIPE DHE LETËRSINË – SI LËNDË TË DETYRUESHME
2. GJUHËN ANGLEZE – SI LËNDË TË DETYRUESHME ME ZGJEDHJE NË NIVELIN BAZË OSE MË TË LARTË
3. MATEMATIKËN – SI LËNDË ME RËNDËSI NË NIVELIN BAZË OSE MË TË LARTË

Provimi Profesional përbëhet nga një pjesë e arsimit të përgjithshëm dhe teoria profesionale ose një lëndë e teorisë profesionale. Lëndët e arsimit të përgjithshëm në Provimin Profesional jepen nëpërmjet zhvillimit të testit. Lëndët e arsimit të përgjithshëm jepen në organizimin e Qendrës së Provimeve. Provimi nga teoria profesionale jepet me shkrim (test), ndërsa provimi në lëndën e teorisë profesionale jepet me gojë.

Nxënësit që mbarojnë klasën e IV sipas programeve arsimore të modularizuara dhe që vazhdojnë shkollimin, e japin Provimit Profesional në mënyrë eksterne. Provimi Profesional përbëhet nga tri pjesë (provime), pjesën e arsimit të përgjithshëm të provimit e përbëjnë dy lëndë mësimore, ndërsa pjesën profesionale e përbën provimi nga teoria profesionale:

1. Gjuhë malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsi/Gjuhë shqipe dhe letërsi,
2. Matematikë ose Gjuhë angleze (në përputhje me programin arsimor) dhe
3. Teoria profesionale

Ata nxënës të cilët e kryejnë klasën e IV sipas programeve arsimore të modularizuara dhe që nuk e vazhdojnë shkollimin, e japin Provimin Profesional në mënyrë interne, në organizimin e shkollës:

1. Gjuhë malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsi/Gjuhë shqipe dhe letërsi,
2. Matematikë ose Gjuhë angleze (në përputhje me programin arsimor) i

3. Punim Profesional (tema zgjidhet nga katalogu i provimit).

Nxënësit të cilët e përfundojnë klasën e IV sipas programeve arsimore të miratuara në vitin shkollor 2017-2018, dhe që vazhdojnë shkollimin, i nënshtrohen Provimit Profesional ekstern të përbërë nga tri pjesë (provime). Pjesën e arsimit të përgjithshëm të provimit e përbëjnë dy lëndë mësimore, ndërsa pjesën profesionale e përbën provimi nga lënda profesionale-teorike:

1. Gjuhë malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsi/Gjuhë shqipe dhe letërsi,
2. Matematikë ose Gjuhë angleze (në përputhje me programin arsimor) dhe
3. Lënda profesionale-teorike (jepet me gojë, duke tërhequr fletët me pyetje të cilat i hartojnë komisionet që i ka formuar Komisioni Shtetëror për përcjelljen e Provimit të Maturës dhe Provimit Profesional).

Nxënësit të cilët e përfundojnë klasën e IV sipas programeve arsimore të miratuara në vitin shkollor 2017-2018, dhe të cilët nuk e vazhdojnë shkollimin, e japin provimin në mënyrë interne në organizimin e shkollës:

1. Gjuhë malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsi/Gjuhë shqipe dhe letërsi,
2. Matematikë ose Gjuhë angleze (në përputhje me programin arsimor) dhe
3. Punim Profesional (tema zgjidhet nga katalogu i provimit).

ME RËNDËSI:

NXËNËSI I NJË SHKOLLE TË MESME PROFESIONALE QË NUK PLANIFIKON TË VAZHDOJË SHKOLLIMIN I NËNSHTROHET PROVIMIT PROFESIONAL TË ORGANIZUAR NGA SHKOLLA (E PËRDORIM TERMIN INTERN SEPSE PROVIMET PËRGATITEN DHE VLERËSOHEN NË SHKOLLË). KËTA NXËNËS I NËNSHTROHEN PROVIMEVE ME SHKRIM, PROVIMEVE ME GOJË DHE MBROJTJES SË PUNIMIT PROFESIONAL NË PËRPUTHJE ME KATALOGËT E PROVIMEVE PËR NJË PROGRAM TË CAKTUAR ARSIMOR.

NËSE EDHE PAS NJË KOHE TË CAKTUAR NXËNËSI VENDOS TË VAZHDOJË SHKOLLIMIN, AI MUND TË APLIKOJË PËR DHËNIEN E PROVIMIT NË MËNYRË EKSTERNE NË PËRPUTHJE ME RREGULLOREN PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË PROVIMIT PROFESIONAL PËR NXËNËSIT QË VAZHDOJNË SHKOLLIMIN.



KATALOGËT E PROVIMEVE

Në katalogun e provimit, i cili është një lloj informatori, janë informacionet e provimeve, janë dhënë qëllimet e përgjithshme, struktura e provimit, programi i provimit me fushat qëllimet, shembulli i testit me udhëzimin e vlerësimit me pikë dhe literatura. Katalogu i provimit u kush-tohet nxënësve dhe mësimehdhënësve.

Në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve mund të gjenden katalogët për lëndë të detyrueshme/arsimit të përgjithshëm dhe për lëndët me rëndësi të veçantë. Gjithashtu, në faqen e internetit gjenden edhe shembujt e testeve nga vitet e mëparshme dhe zgjidhjet e tyre. <https://iccg.co.me/katalozi-za-matur-ski-ispit-skolska-2020-21/>

Katalogët e provimeve për lëndët e teorisë profesionale janë pjesë përbërëse e programit arsimor të modularizuar, prandaj informacionet për përmbajtjen e katalogut kërkoni nga mësimehdhënësit në shkollën tuaj.

REKOMANDIMI

KENI KOHË TË MJAFTUESHME DHE TË GJITHË INFORMACIONIN QË JU MUNDËSON TË PËRGATITENI MIRË PËR DHËNIEN ME SUKSES TË PROVIMIT TË MATURËS/PROVIMIT PROFESIONAL. PËR ÇDO PYETJE SHITESË MUND T'JU DREJTOHENI MËSIMDHËNËSVE NË SHKOLLË, KOORDINATORIT TË SHKOLLËS PËR PROVIMIN E MATURËS/PROVIMIN PROFESIONAL OSE QENDRËS SË PROVIMEVE NË E-MAILIN IC@ICCG.EDU.ME.



TANI E DI SE:

- ▶ DUHET T'U NËNSHTROHEM TRE PROVIMEVE NË PROVIMIN E MATURËS/PROVIMIN PROFESIONAL. SI NXËNËS I GJIMNAZIT DUHET TË JAP DY PROVIME NGA PJESA E DETYRUESHME DHE NJË LËNDË TË RËNDËSISHME. SI NXËNËS I NJË SHKOLLE TË MESME PROFESIONALE DHE ARTISTIKE QË DËSHIRON TË VAZHDOJË SHKOLLIMIN, JAP DY PROVIME NGA PJESA E ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM DHE TEORIA PROFESIONALE.
- ▶ GJUHËN ANGLEZE DHE MATEMATIKËN MUND T'Ë JAP NË NIVELIN BAZË OSE NIVELIN MË TË LARTË;
- ▶ PROVIMET NË ÇDO AFAT TË PROVIMIT REALIZOHEN NË TË NJËJTËN KOHË DHE NË TË NJËJTËN MËNYRË NË TË GJITHË VENDIN;
- ▶ ËKZISTOJNË KATALOGËT E PROVIMEVE NGA TË CILËT MUND TË MËSOJ STRUKTURËN E PROVIMIT, ÇFARË TESTOHET, TË SHOH SHEMBULLIN E TESTIT ME UDHËZIMIN E VLERËSIMIT ME PIKË DHE LITERATURËN.



VIJON PJESA QË KA TË BËJË ME:

- ▶ PARAQITJEN,
- ▶ DHËNIEN E PROVIMIT DHE ME
- ▶ REZULTATET E PROVIMIT TË MATURËS/PROVIMIT PROFESIONAL.

Për të shmangur gabimet gjatë paraqitjes, është e rëndësishme që të kontrolloni me kujdestarin e klasës nëse në ditarin elektronik janë paraqitur pikërisht ato lëndë dhe nivelet që keni dëshiruar.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse lënda që dëshironi të merrni si lëndë me rëndësi në Provimin e Maturës e plotëson standardin e Maturës, drejtojeni kujdestarit të klasës ose koordinatorit të shkollës për verifikim.

ME RËNDËSI:

PARAQITJA PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL

Për dhënien e Provimit të Maturës ose Provimit Profesional ekzistojnë 3 afate: i qershorit, i gushtit dhe i janarit. Me kalendarin e Provimit të Maturës/Provimit Profesional përcaktohet data dhe koha e dhënies së provimit.

PËRCAKTIMI PËR LËNDËT DHE NIVELET

Suksesi në Provimin e Maturës dhe Provimin Profesional duhet të mundësojë edhe një përzgjedhje më objektive gjatë regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë. Është e rëndësishme që të informoheni me kohë për kushtet e nevojshme për regjistrimin në fakultete, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, natyrisht nëse jeni të interesuar të studioni jashtë kufijve të shtetit tonë.

Nëse keni një dilemë se cilat lëndë t'i paraqitni, kërkonin ndihmë nga njerëzit që ju besoni. Për të marrë një vendim të mirë, mund të ndihmoheni nga prindërit/kujdestarët, koordinatori i shkollës, kujdestari i klasës ose mësimdhënësit e lëndëve, bashkëpunëtorët profesional në shkollë.

Shumica e shkollave bëjnë një anketë (ose mbledhin të dhëna në ndonjë mënyrë tjetër) në të cilën nxënësit paraqiten për lëndët dhe nivelet të cilat do t'i japin në Provimin e Maturës dhe Provimin Profesional. Nxënësi duhet të vendosë brenda datës 5 shkurt të vitit aktual.

Pas mbledhjes së të dhënave, kujdestari i klasës i paraqet lëndët e përzgjedhura në ditarin elektronik. Paraqitja e lëndëve në MEIS është e kufizuar në kohë.

Lëndën, gjegjësisht nivelin e dhënies së provimit, nxënësi mund ta ndryshojë deri në ditën e futjes së të dhënave në ditarin elektronik. Pas përfundimit të paraqitjes, nuk është e mundur të ndryshohet lënda apo niveli.

Dua të studioj jashtë vendit dhe për regjistrim kërkojnë kalimin e 4 lëndëve në Provimin e Maturës ose Provimin profesional. Çfarë duhet të bëj?

Siç e dini, në sistemin tonë 3 lëndë janë të detyrueshme, por nëse duhet të kaloni 4 lëndë për të vazhduar shkollimin – ka një zgjidhje.

Pra, kur të vendosni të vazhdoni shkollimin jashtë vendit, kontrolloni në njësinë e dëshiruar të universitetit nëse duhet të keni dhënë katër provime. Nëse po, vendosni se cila lëndë e rëndësishme ju nevojitet për arsimim të mëtejshëm.

Për këtë informoni koordinatorin e shkollës për Provim të Maturës/Provim Profesional, i cili do t'ia përcjellë këtë informacion Qendrës së Provimeve. Do të merrni udhëzime të mëtejshme sepse për miratimin e lëndës së katërt duhet t'i drejtoheni Komisionit Shtetëror për Provim të Maturës/Provim Profesional dhe shkolla do të marrë udhëzime nga Qendra e Provimeve për vetë orarin e paraqitjes së provimeve.

NË KËTË RAST DUHET TË PARAQITNI:

1. Gjuhën malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsinë/Gjuhën shqipe dhe letërsinë;
2. Gjuhën angleze – në nivelin që dëshironi ose që kërkohet për fakultetin e dëshiruar;
3. Matematikën – në nivelin që dëshironi ose që kërkohet për fakultetin e dëshiruar;
4. Lëndën me rëndësi – zgjidhni lëndën e cila ju vlerësohet me pikë për regjistrim në fakultet.

TANI E DI:

- ▶ SI DHE DERI KUR PARAQITET PROVIMI I MATURËS/PROVIMI PROFESIONAL;
- ▶ DERI KUR MUND TA NDRYSHOJ NIVELIN E DHËNIES SË PROVIMIT OSE LËNDËS ME ZGJEDHJE;
- ▶ KUJT DUHET T'Ë DREJTOHEM PËR TË KONTROLLUAR PËRMBUSHJEN E STANDARDIT TË MATURËS;
- ▶ SE DUHET TË KONTROLLOJ NËSE ZGJEDHJA IME E LËNDËS DHE NIVELIT TË DHËNIES SË PROVIMIT TË MATURËS/PROVIMIT PROFESIONAL ËSHTË PARAQITUR SAKTË;
- ▶ SE MUND TË MARR 4 LËNDË NËSE MË DUHEN PËR TË VAZHDUAR SHKOLLIMIN NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË JASHTË MALIT TË ZI.

DHËNIA E PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL

Datat e dhënies së Provimit të Maturës/Provimit Profesional janë përcaktuar me Kalendarin e shkollës për atë vit shkollor. Kalendarin shkollor e miraton Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe u dorëzohet shkollave në fillim të vitit shkollor.

Në fillim të viti shkollor, shkolla është e detyruar të njoftojë nxënësit e klasave përfundimtare për datat e dhënies së lëndëve për Provimin e Maturës/Provimit Profesional.

Për t'u përgatitur sa më mirë për provimet, është e rëndësishme të njiheni me rregullat e sjelljes gjatë provimit dhe detyrimet që keni.

VIJOJNË PYETJET MË TË ZAKONSHME QË KANË NXËNËSIT NË LIDHJE ME DHËNIEN E PROVIMIT TË MATURËS/PROVIMIT PROFESIONAL.

1. Sa provime mund të jap në një ditë?

Në një ditë mund t'i nënshtroheni vetëm një provimi.

2. Si do ta di se në cilën sallë ku do të mbahet provimi jam caktuar?

Me të gjitha detajet me kohë do t'ju njoftoi koordinatori i shkollës. Orari i saktë për sallat/klasat ku do të mbahen provimet do të publikohet në tabelën e njoftimeve/derën e hyrjes në shkollë dhe në derën e klasave/sallave të provimeve në prag të provimit.

3. A duhet të kem dokument personal të identifikimit kur hyj në sallën e provimit?

Çdo nxënës duhet të ketë një dokument personal me fotografi të cilin duhet t'ia tregojë administratorit të testit para fillimit të provimit.

4. Po sikur të harroj dokumentin personal të identifikimit?

Në këtë rast, ju mund t'i nënshtroheni provimit, administratori i testit do të shënojë në proces-verbal se nuk keni dokument personal të identifikimit. Koordinator i shkollës, me ndihmën e kujdestarit të klasës, do të përpiqet të kontaktojë me prindërit/kujdestarët për të siguruar një dokument identifikimin. Nëse dokumenti nuk është sjellë deri në fund të provimit, do të konsiderohet se nuk keni marrë pjesë në provim.

REKOMANDIMI:

Para se të niseni në provim, kontrolloni nëse keni marrë letërnjoftimin apo pasaportën.

5. Cilat mjete të punës lejohen?

Për çdo provim parashikohet se cilat mjete të punës lejohen. Këtë do ta zbuloni në katalogët e provimit për një lëndë të caktuar dhe gjithmonë mund ta pyesni koordinatoren e shkollës.

6. A mund të sjell sende personale në provim?

Jo. Gjatë provimit mund të keni vetëm mjetet e lejuara të punës dhe një shishe uji plastike. Të gjitha sendet tjera i vendosni në vendin e caktuar në sallën ku mbahet provimi.

ME RËNDËSI:

Ndalohet rreptësisht futja e telefonave celularë, orëve inteligjente, kufjeve dhe pajisjeve tjera elektronike që përdoren për transmetimin e të dhënave dhe të gjitha ato duhet të vendosen në vendin e caktuar për to. Përndryshe, rrezikoni të largoheni nga provimi.

7. Po sikur të vonohem në provim?
Vonesa nuk lejohet. Pas orës 11 nuk do të lejohet të hyni në provim.

KËSHILLA:

Sipas rregullores, nxënësit duhet të jenë para sallës së provimit 30 minuta para provimit, ndaj planifikoni ardhjen tuaj në provim me mençuri.

8. A lejohet të largoheni nga salla e provimit?

Gjatë provimit nuk lejohet dalja nga vendi ku mbahet provimi për 30 minutat e para. Nëse dilni nga vendi ku mbahet provimi pa leje, humbisni të drejtën e dhënies së provimit gjatë atij afati të provimit.

9. Sa zgjasin provimet?

Në varësi të lëndës dhe nivelit të dhënies së provimit, kohëzgjatja e provimeve në lëndët e arsimit të detyrueshëm/të përgjithshëm është e ndryshme.

- ▶ Gjuha malazeze-serbe, boshnjake, kroate dhe letërsia/Gjuha shqipe dhe letërsia – kohëzgjatja e provimit është 180 minuta.

Të gjithë nxënësit zhvillojnë të njëjtin test pavarësisht nëse kanë mbaruar gjimnazin apo ndonjë shkollë profesionale.

- ▶ Gjuha e parë e huaj:
 - nivel bazë – 150 minuta.
 - nivel më i lartë – kohëzgjatja e provimit 180 minuta.
- ▶ Matematika:
 - nivel bazë punohet 120 minuta
 - nivel më i lartë – kohëzgjatja e provimit 150 minuta
- ▶ Analiza me algjebër:
 - nivel bazë – kohëzgjatja e provimit 150 minuta
 - nivel më i lartë – kohëzgjatja e provimit 180 minuta
- ▶ Lënda me rëndësi/Teoria profesionale – kohëzgjatja e provimit nga 90 deri në 180 minuta

Provimet fillojnë në orën 11.00 në të gjitha shkollat dhe për të gjitha lëndët.

NË VETË PROVIMIN

Gjatë kohëzgjatjes së provimit në sallën e provimit duhet të jenë administruesi kryesor i testit (një mësimmhënës nga shkolla tjetër) dhe administruesi i testit (një mësimmhënës nga shkolla jote). Roli i tyre është të shpërndajnë materialin e provimit, të sigurojnë respektimin e rregullave në ambientin e mbajtjes së provimit dhe të paketojnë testet e provimit pas përfundimit të provimit.

Vijon përkshkrimi i procedurës së vetë provimit që ka të bëjë me nxënësin:

1. Vendet ku duhet të uleni janë të shënuara me numra dhe janë të përcaktuara sipas renditjes nga lista. Me rastin e thirrjes dhe identifikimit, mbani mend numrin tuaj rendor dhe uluni pikërisht në atë vend.
2. Pas hyrjes së të gjithë kandidatëve administruesi i testit do t'i ftojë tre nxënës të cilët me nënshkrimin e tyre do të verifikojnë se qesja e sigurisë është e ngjitur ashtu siç duhet të jetë. Pas kësaj, hapet qesja dhe fillon shpërndarja e testeve.
3. Administruesi i testit i thërret nxënësit një nga një dhe u jep librezën e testit, fletën e përgjigjeve për pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë, fletën me shifër (në të cilën është emri yt dhe atë e merr me veten dhe e ruan për të kontrolluar rezultatin) dhe dy shifra. Njëra shifër ngjitet në librezën e testit dhe tjetra në fletën e përgjigjeve. Me rastin e marrjes, por edhe kur e dorëzon testin, duhet të nënshkruhesh në formularin 01;
4. Kur të bjerë zilha, mund të filloni provimin. Gjatë provimit, dera është e hapur. Përgjithim bëjnë provimet që kanë një pjesë dëgjimore. Derisa dëgjoni detyrën, dera mbyllet dhe hapet pas ushtrimit.
5. Shkruani përgjigjet në hapësirën e parashikuar për përgjigjen/zgjidhjen e detyrës.
6. Detyrimisht plotësoni fletën e përgjigjeve të cilën e merrni si pjesë përbërëse të testit. Përgjigjet e rrethuar/qarkuara vetëm në librezën e testit nuk do të vlerësohen me pikë; (kjo është shumë e rëndësishme dhe shpesh ndodh që nxënësit harrojnë t'i kalojnë përgjigjet në fletën e përgjigjeve!)


7. Shënoni pa mëdyshje përgjigjen/zgjidhjen të cilën dëshironi ta vlerësojë vlerësuesi. Nëse shënoni një përgjigje dhe më pas ndryshoni mendimin, ndiqni udhëzimet se si ta shënoni saktë përgjigjen përfundimtare.
8. Nëse e përfundoni punën tuaj më herët, me ngritjen e dorës do t'ia tërhiqni vëmendjen administruesit të testit që e keni përfunduar punën në mënyrë që të mos i pengoni nxënësit tjerë. Ta keni parasysh se nuk mund të largoheni nga salla ku mbahet provimi gjatë 30 minutave të parë të provimit.
9. Nëse keni përfunduar punën, fletën e përgjigjeve e vendosni në librezën e testit (menjëherë pas fletës së parë) dhe ia dorëzoni administruesit të testit. Mos harroni të nënshkruheni në formularin O1 kur dorëzoni librezën e testit.
10. Në fund të kohës së caktuar për provim, administruesi kryesor i testit do t'informojë tre nxënësit e fundit që të mbeten në sallën e provimit derisa të paktohen librezat e testit në qesen e sigurisë dhe të mbyllet qesja para tyre. Me nënshkrimin e tyre në qesen e **sigurisë**, nxënësit konfirmojnë se materiali i provimit është i paketuar siç duhet.
11. Kopjimi dhe veprimet e ngjashme të cilat nuk lejohen do të sanksionohen edhe pas provimit, gjatë vlerësimit.
12. Nëse prishni rendin në provim, rrezikoni të sanksionoheni me largim nga provimi dhe punimi juaj nuk do të kontrollohet.

KANDIDATI PRISH RENDIN NË PROVIM NËSE:

- ▶ sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (pengon kandidatin tjetër, shikon prapa ose anash, bisedon, përkatësisht merret vesh, etj.;
- ▶ nuk u përmbahet udhëzimeve të administruesit kryesor të testit dhe administruesit të testit;
- ▶ përpiket ta ndërpresë provimin, prish rrjedhën e provimit, fyen ose kërcënon administratorin kryesor të testit, administratorin e testit ose përfaqësuesin e Qendrës së Provimeve;
- ▶ posedon mjete të palejuara (letër, libër, telefon celular dhe pajisje tjetër elektronike);
- ▶ cenon sekretin e identitetit të kandidatit duke firmosur me emër dhe mbiemër të plotë ose në ndonjë mënyrë tjetër cenon sekretin e identitetit;
- ▶ kopjon nga kandidati tjetër;
- ▶ i mundëson kandidatit tjetër të kopjojë.

ME RËNDËSI!

Punimi duhet të shkruhet me stilolaps/stilograf. Përgjigjet e shkruara me laps të thjeshtë nuk do të vlerësohen, prandaj mos harroni që t'i përshkruani përgjigjet me stilolaps dhe që t'i kaloni përgjigjet me zgjedhje të shumëfishtë në fletën e përgjigjeve. Eseja duhet të jetë e shkruar në vendin e paraparë për shkrimin e esesë, assesi në fletët e parashikuara për konceptin. Eseja e shkruar në vendin e paraparë për koncept nuk do të vlerësohet!!!



NË PROVIM NUK LEJOHET:

- ▶ prezantimi i rrejtshëm,
- ▶ sjellja e sendeve personale përveç pajisjeve të lejuara të punës dhe një shishe ujë,
- ▶ hapja e detyrave të provimit përpara kohës së lejuar,
- ▶ pengimi i nxënësve të tjerë,
- ▶ kopjimi nga një nxënës/se tjetër,
- ▶ lejimi i një nxënësi/se tjetër të kopjojë,
- ▶ përdorimi i mjeteve të palejuara të punës,
- ▶ përdorimi i pajisjeve elektronike,
- ▶ dëmtimi i shifrës në librezën e testit,
- ▶ mosrespektimi i shenjës për përfundimin e provimit,
- ▶ ndryshimi i klasës dhe vendit të ulësuar tuaj të përcaktuar nga Qendra e Provimeve,
- ▶ grisja e faqeve nga librezja e testit.

DETYRA JUAJ DO TË VLERËSOHET ME ZERO PIKË NËSE:

- ▶ përgjigjja është e pasaktë
- ▶ përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë NUK është kaluar në fletën e përgjigjeve
- ▶ është rrethuar/qarkuar ose shkruar përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- ▶ përgjigjja/eseja është shkruar në mënyrë të palexueshme
- ▶ përgjigjja/eseja është shkruar me laps grafit
- ▶ eseja NUK është shkruar në vendin e parashikuar, por vetëm në fletët e konceptit (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)!!! Kushtojini vëmendje të veçantë kësaj sepse ndodh shpesh kjo. Eseja e shkruar në vendin e paraparë për koncept nuk vlerësohet.
- ▶ punimi është nënshkruar



TANI E DI:

- ▶ QË NË FILLIM TË VITIT SHKOLLOR DO TË JEM NË DIJENI TË KALENDARIT TË PROVIMIT TË MATURËS/PROVIMIT PROFESIONAL;
- ▶ SE DO TË INFORMOHEM ME KOHË SE NË CILËN SALLË TË PROVIMIT DO TË JEM;
- ▶ KOHËN KUR FILLON PROVIMI DHE SA ZGJASIN PROVIMET;
- ▶ SA PROVIME MUND TË JAP NË NJË DITË;
- ▶ SE ME RASTIN E HYRJES NË SALLËN E PROVIMIT, DUHET TË TREGOJ DOKUMENTET PERSONALE;
- ▶ SE NUK MUND TË LARGOHEM NGA SALLA E PROVIMIT PËR 30 MINUTAT E PARA;
- ▶ SE ÇFARË PAJISJESH DO TË PËRDOR GJATË PROVIMIT;
- ▶ SE NUK GUXOJ TË VONOJ NË PROVIM;
- ▶ SE FUTJA E TELEFONAVE DHE PAJISJEVE TË TJERA ELEKTRONIKE ËSHTË E NDALUAR;
- ▶ SE PËR PRISHJE TË RENDIT NË PROVIM DHE SHKELJA E RREGULLAVE DO TË SANKSIONOHEM ME LARGIM NGA PROVIMI DHE SE TESTI IM NUK DO TË KONTROLLOHET;
- ▶ SE GJITHÇKA QË MË INTERESON LIDHUR ME PROCEDURAT NË PROVIM MUND TË PYES KOORDINATORIN E SHKOLLËS NË SHKOLLËN TIME OSE KOORDINATORIN PËR PROVIM TË MATURËS/PROVIM PROFESIONAL NË QENDRËN E PROVIMEVE.

PËR REZULTATET E PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL

Pas përfundimit të provimit, librezat e testit, të paketuara në qese sigurie, i dorëzohen Qendrës së Provimeve për vlerësim. Çdo test e kontrollojnë dhe vlerësojnë dy vlerësues, të pavarur nga njëri-tjetri. Në rast se ka dallim në vlerësimin e testit nga dy vlerësues, testi vlerësohet për herë të tretë.

Nëse vlerësuesit vërejnë gjatë vlerësimit se nxënësi ka përdorur mjete të palejuara, ka kopjuar nga kandidati tjetër përgjigjen në pyetjen e provimit, përkatësisht detyrën ose i ka lejuar nxënësit tjetër ta kopjojë përgjigjen në pyetjen e provimit, përkatësisht detyrën ata do ta shpëgojnë këtë në librezën e testit dhe ato librezat e testit nuk do të vlerësohen.

Nxënësi ka dhënë Provimin e Maturës/Provimin Profesional nëse merr notë kaluese në të gjitha lëndët. Nëse ka notë të pamjaftueshme (1) në një ose më shumë lëndë, nuk e ka dhënë Provimin e Maturës dhe udhëzohet ta japë provimin në afatin e ardhshëm të provimit.

PYETJET MË TË SHPESHTA NË LIDHJE ME REZULTATET E PROVIMIT

1. Kur do t'i di rezultatet?

Kalendarin me aktivitetet pas realizimit të provimeve (datën e publikimeve të rezultateve paraprake, shikimit të testit, paraqitjen e ankesave dhe shpalljen përfundimtare të rezultateve) Qendra e Provimeve ua dërgon shkollave dhe e publikon në faqen e internetit.

Rezultatet tuaja mund t'i shikoni përmes linkut së publikuar në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve. Rezultatet kërkon duke futur shifrën që keni marrë në provim ose përmes numrit unik amëz të identifikimit.

2. A mund ta shoh testin pasi të publikohen rezultatet paraprake?

Sigurisht se po. Qendra e Provimeve organizon shikimin e testit për të gjithë nxënësit që duan të shohin testin. Nxënësit paralajmërojnë ardhjen për shikimin e testit ekskluzivisht përmes shkollës në oraret të cilat janë përcaktuar më

parë me orarin e aktiviteteve. Shkolla i dërgon Qendrës së Provimeve shifrat e nxënësve që kanë paralajmëruar ardhjen e tyre.

Për çdo nxënësi që vjen për të shikuar testin, Qendra e Provimeve përgatit testin dhe listën me rezultatet paraprake (numrin e pikëve për të gjitha ushtrimet). Ky aktivitet kërkon kohë dhe për këtë arsye është jashtëzakonisht e rëndësishme të respektohen oraret e parashikuara në kalendarin e aktiviteteve.

Kur të vini të shikoni testin, do të merrni testin dhe listën me rezultatet paraprake, të cilat do t'i shikoni në prani të një bashkëpunëtori të Qendrës së Provimeve.

3. Nuk jam i kënaqur me notën që kam marrë.

Çfarë të bëj në atë rast?

Nëse nxënësi nuk është i kënaqur me notën, brenda 24 orëve nga publikimi i rezultateve paraprake, ai mund të bëjë ankesë me shkrim pranë Qendrës së Provimeve. Nxënësi paraqet ankesën në shkollë dhe shkolla e përcjell atë në Qendrën e Provimeve. Ankesa përfshin shifrën e nxënësit dhe argumentimin përse kërkohet një vlerësim i ri.

4. A mund të paraqes ankesën në notë nëse nuk kam qenë për ta shikuar testin?

Po, nxënësi mund të paraqes ankesën për notën, pavarësisht nëse ka qenë apo jo për të parë testin. Shikimi i testit nuk është kusht për paraqitjen e ankesës.

5. Sa kohë i duhet Komisionit të Ankesave në notë për t'u përgjigjur?


Komisioni i Ankesave në notë vendos nëse ankesa është e arsyeshme brenda tre ditëve. Nëse vërtetojnë se ankesa është e arsyeshme, bëhet një vlerësim i ri, për të cilin mbajnë shënim. Për të gjitha ankesat, të arsyetuara dhe të paarsyetuara Komisioni merr vendimin që i dërgohet shkollës që ka dërguar ankesën. Shkolla më tej informon kandidatin për vendimin përfundimtar. Vendimi i Komisionit Vlerësues të Ankesave në notë është përfundimtar.

Pas këtij aktiviteti publikohen rezultatet përfundimtare dhe shkollat lëshojnë diploma për dhënien e Provimit të Maturës/Provimit Profesional.

TANI E DI:

- ▶ KUR DO TË MËSOJ PËR REZULTATET E PROVIMEVE
- ▶ SE PROVIMIN TË CILIN NUK E KAM DHËNË MUND TA JAP PËRSËRI NË AFATIN E ARDHSHËM TË PROVIMIT
- ▶ SE MUND TA SHIKOJ TESTIN DITËN E PARASHIKUAR PËR SHIKIMIN E TIJ QË ORGANIZOHET NË QENDRËN E PROVIMEVE
- ▶ SE NËSE NUK JAM I KËNAQUR ME NOTË, MUND TË PARAQES ANKESËN NË NOTËN E DHËNË





SHPRESOJMË QË TË PAKTËN T'JU KEMI LEHTËSUAR PAKSA TË GJITHË PROCESIN, QË NGA APLIKIMI DERI NË PËRFUNDIMIN E MATURËS/ PROVIMIT PROFESIONAL. KY PROVIM ËSHTË VETËM NJË NGA SHUMË HAPAT NË RRUGËN DREJT SUKSESIT TUAJ. MËSONI ME ZELL, INVESTONI KOHËN E NEVOJSHME PËR TË PUNUAR DHE SUKSESI NUK DO TË MUNGOJË.

JU UROJMË SUKSESE NË PËRGATITJET TUAJA!

